



Përmbajtja

Shënohet Dita e Ambientit	3
3 315 hektar planifikohen të mbillen këtë pranverë në Malishevë	4
Kryetari i Komunës takoi kryepleqtë e fshatrave	4
Situata e sigurisë e qetë dhe stabile	5
Miratohen ndryshimet në dy rregullore komunale	7
Kryetari ka vazhduar takimet me qytetar	8
KDI vlerëson punën e Zyrës për Informim të Malishevës	8
Fillimi i spërkatjes kundër rriqrave varet nga kushtet atmosferike	9
Kryetari Kilaj: “Qendra e Kompetencës, rrugë drejt Evropës”	10

Shënohet Dita e Ambientit

Malishevë, 1 prill

Me rastin e shënimit të 1 Prillit, Ditës Ndërkombëtare për Mbrojtje të Ambientit, është organizuar pastrimi i hapësirave publike në qytetin e Malishevës dhe në tërë territorin e komunës.



Në kuadër të kësaj dite është shpërndarë një fletëpalosje, e përgatitur nga Zyra për Informim Publik, përmes së cilës njoftohen qytetarët në lidhje me Rregulloren për Mirëmbajtjen e Pastërtisë në Territorin e Komunës së Malishevës.

Aksionit të sotëm, për pastrimin e qytetit i ka prirë kryetar i komunës, z.Isni Kilaj me të gjithë punëtorët e administratës, të cilit i janë bashkuar edhe institucionet tjera në Malishevë, si Policia e Kosovës, institucionet shkollore, shëndetësore, etj.

Muaji Prill është shpallur muaj i ambientit në Malishevë, ku përmes aksioneve për largimin e mbeturinave, synohet pastrimi i ambienteve në të gjitha vendbanimet e komunës së Malishevës.

3 315 hektar planifikohen të mbillen këtë pranverë në Malishevë

Malishevë, 1 prill

Bazuar në planifikimin e Drejtorisë Komunale për Bujqësi, për mbjelljet pranverore, planifikohen të mbillen 3 315.6 hektar, me kulturat lavërtarie, perimekultura dhe bimë foragjere, të gjitha këtu në sektorin privat.

Sipërfaqen më të madhe të mbjelljeve, e zë misri dhe fasulja, ku sipas shënimeve të grumbulluara në terren, priten të mbillen 3100 hektar, pastaj vjen elbi pranveror me 97 hektar, misri për silazh 48 hektar, mbjellja e patateve me 37 hektar, e kështu me radhë.

Për mbjellje pranverore, po ashtu planifikohen të mbillen edhe një sipërfaqe prej 90 hektarësh me perime, si Spec, Domate, Patate, Lakra e tjera, kultura që kryesisht mbillen për nevoja familjare, ndërsa bimë foragjere planifikohen të mbillen rreth 36 hektar.

Kryetari i Komunës takoi kryepleqtë e fshatrave

Malishevë, 2 prill

Kryetari i Komunës, z. Isni Kilaj, sot ka mbajtur një takim me kryepleqtë e fshatrave të komunës së Malishevës, ku i ka njoftuar ata se gjatë këtij muaji, do të mbaj takime në të gjitha fshatrat, në kuadër të fushatës për mbrojtje të ambientit në tërë territorin e komunës, si dhe i ka njoftuar me Rregulloren për Mirëmbajtjen e Pastërtisë në territorin e Malishevës.





“Unë kërkoj nga ju mbështetje për largimin e mbeturinave nga hapësirat publike dhe mbajtjen e pastërtisë”, iu ka thënë kryetari Kilaj udhëheqësve të fshatrave, me ç’rast është shpërndarë dhe i ka njoftuar edhe me fletëpalosjen për rregulloren mbi mbrojtjen e ambientit.

“Hedhja e mbeturinave, është e papranueshme dhe padurueshme”, ka thënë Kilaj, duke folur për dukurinë e hedhjes së mbeturinave në hapësirat publike, si dhe për gjobat që parashihen sipas rregullores, e cila do të zbatohet në përpikëri.

“Mbeturinat do të largohen, por duhet ta ruani ambientin, prandaj kërkoj edhe nga ju mbështetje për zbatimin e kësaj rregulloreje”, ka vazhduar më tej kryetari i komunës, z.Isni Kilaj.

Gjatë debatit, përfaqësuesit e fshatrave kanë kërkuar shtimin e numrit të kontejnerëve nëpër vendbanime si nevojë e domosdoshme që mbeturinat të mos hedhen në rrugë apo vende tjera të ndaluar, pastaj shtimin e aktivitetit të inspektorëve komunal për zbatimin e tërësishëm të kësaj rregulloreje, si dhe kanë përkrahur këtë iniciativë të kryetarit, që gjatë muajit Prill të largohen mbeturinat nga vendet publike në të gjitha vendbanimet.

Më pas, kryetari, ata janë njoftuar për punët e deritanishme në komunë, projektet që janë duke u realizuar, ndërsa drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Skënder Hoti, i ka njoftuar për projektin në lidhje me eliminimin e rriqrave dhe spërkatjet që do të bëhen.

“Projekti është i gatshëm dhe brenda disa ditëve do të filloj të realizohet, ku parashihet dezinfektimi dhe derratizimi i sipërfaqeve, ndërsa nga ana juaj kërkoj mbështetje për realizimin e këtij projekti”, ka njoftuar drejtori Hoti.

U mbajt mbledhja e dytë e KKSB-së

Situata e sigurisë e qetë dhe stabile

Malishevë, 8 prill

Në mbledhjen e dytë të Këshillit Komunal për Sigurinë në Bashkësi (KKSB), situata e sigurisë në Komunën e Malishevës, u vlerësua e qetë dhe stabile, përderisa ende mbetet shqetësuese dukuria e aksidenteve në trafik si pasojë e vozitjes në mospërshtatje të shpejtësisë me kushtet në komunikacion, me gjithë rënien e numrit të rasteve të tilla.

Në këtë takim, përveç anëtarëve të rregullt, mori pjesë edhe Nexhmi Krasniqi, Drejtori i Policisë për Regjionin e Prizrenit.

Nënkryetari i komunës, z. Rexhep Mazreku, në fillim të mbledhjes tha se, situata e sigurisë është e qetë dhe stabile dhe kjo falë angazhimeve të Policisë së Kosovës dhe institucioneve tjera përgjegjëse për sigurinë. “Edhe pse ne si komunë, ballafaqohemi me probleme të natyrës sociale që në disa raste mund të jenë edhe shkaktar të veprave kriminale, falë angazhimit të organeve të sigurisë, kemi një situatë shumë të qetë në këtë aspekt”, tha nënkryetari Mazreku.



Me këtë rast Drejtori i Policisë së Kosovës, për regjionin e Prizrenit, Nexhmi Krasniqi, i cili mori pjesë në këtë mbledhje të KKS-së, prezencën e tij e arsyetoj me qëllimin njoftues në lidhje me situatën e sigurisë në komunën e Malishevës dhe planeve për rastet emergjente. Qëllim tjetër sipas Drejtori Krasniqi ishte edhe nevoja e koordinimit të këtyre planeve me mekanizmat tjerë në komunë. “Në rast nevojë, çdo gjë duhet të jetë e koordinuar mes policisë dhe mekanizmave të tjerë institucional”, tha mes tjerash Krasniqi.

Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Halit Zogaj, prezantoi punën e drejtorisë në aspektin e sigurisë së përgjithshme, si dhe angazhimin në dy projekte që lidhen me sigurinë e përgjithshme të qytetarëve: projekti për eliminimin e rriqrave dhe ai për eliminimin e qenve endacak. Po ashtu drejtori Zogaj, njoftoi edhe për harmonizimin e rregulloreve me ligjet në fuqi, si dhe për hartimin e planeve të vlerësimit të rreziqeve.

U.d. i komandantit të stacionit policor në Malishevë, Bekim Begaj, po ashtu e vlerësoi të qetë situatën e sigurisë, përkundër një rasti të vrasjes dhe një rasti të plagosjes aksidentale. Ndërsa për sigurinë në trafik, Begaj tha se, përkundër që vazhdon të jetë ende shqetësuese siguria në trafik, projekti “Të shpëtojmë jetë”, i realizuar nga 12-31 marsi, ka dhënë rezultat, me ç’rast edhe janë shënuar rënie të aksidenteve, qofshin ato me apo pa pasoja fatale. Begaj e ka njoftuar KKS-në edhe për planet e Policisë së Kosovës për rastet emergjente.

Në këtë takim të KKS-së, ishin të pranishëm edhe përfaqësues të KFOR-it dhe të policisë së EULEX-it.

Nga mbledhja kuvendit

Miratojen ndryshimet në dy rregullore komunale

Malishevë, 12 prill

Në mbledhjen e sotme të Asamblesë Komunale, të udhëhequr nga kryesuesi Ragip Begaj, në të cilën ishte i pranishëm edhe kryetari i komunës, z. Isni Kilaj, janë miratuar ndryshimet në dy rregullore, si dhe kërkesa e kryetarit për ndërtimin e fushës së futbollit të madh dhe raporti financiar për vitin 2009.

Pas miratimit të rendit të ditës dhe procesverbalit nga mbledhja e kaluar, kryetari i Komunës, z. Isni Kilaj, ka sqaruar para këshilltarëve komunal, nevojën dhe rëndësinë e ndërtimit të fushës së futbollit të madh, e cila planifikohet të ndërtohet me koncesion. Kjo kërkesë më pastaj është miratuar me shumicë votash.

Në vazhdim janë shqyrtuar rekomandimet e KPF-së, ku para këshilltarëve është prezantuar raporti financiar për vitin 2009, ndërsa kryetari dhe drejtori i drejtorisë për buxhet financa, Vesel Krasniqi, kanë sqaruar të gjitha të hyrat dhe shpenzimet gjatë vitit 2009, ndërsa në fund të kësaj pike, me shumicë votash, këshilltarët kanë miratuar raportin financiar për 2009.

Po ashtu me shumicë të votave dhe me disa sugjerime e



propozime, janë miratuar ndryshimet në dy rregullore, rregullorja për Mirëmbajtjen e Pastërtisë në Territorin e Komunës së Malishevës dhe Rregullorja për Orarin e Punës të Subjekteve Afariste në Territorin e Komunës së Malishevës.

Kryetari ka vazhduar takimet me qytetar

Malishevë, 15 prill

Edhe këtë të enjte, Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, ka vazhduar me pritjen e palëve, drejtpërdrejt në zyrën e tij, duke u njoftuar me problemet që qytetarët në jetën e përditshme dhe në të njëjtën kohë, duke u munduar t’ju gjej zgjidhje, brenda mundësive dhe kompetencave të tij.

Gjatë ditës së sotme, ka pritur në zyrën e tij, nga ora 10 deri në ora 12, afro tridhjetë palë, duke njoftuar me problemet e tyre individuale apo kolektive.

Kryetari Kilaj, në disa raste ju ka ofruar mbështetjen institucionale dhe në disa ju ka ofruar sqarimet e nevojshme dhe procedurat, varësisht prej rasteve , për të kërkuar ndihmë të ndryshme, materiale apo juridike.

Takimet me qytetar, organizohet çdo të enjte, nga ora 10 deri në ora 12, në zyrën e kryetarit të komunës.

KDI vlerëson punën e Zyrës për Informim të Malishevës

Malishevë, 20 prill

Në kuadër të vlerësimit që Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), i bënë punës së komunave në Regjionin e Prizrenit, hynë edhe vlerësimi për faqen elektronike të këtyre komunave, kurse në këtë drejtim një vlerësim i veçantë i bëhet komunës së Malishevës.



Përderisa raporti vlerëson se komunat e Regjionit të Prizrenit janë treguar të pasuksesshme në shfrytëzimin e mundësive që ofron teknologjia informative për promovim të punës së tyre dhe për informimin e qytetarëve me aktivitetet që ndodhin në këto institucione, vlerësim pozitiv jepet për Malishevën.



“Komuna e Malishevës mund të cilësohet më e suksesshme në këtë segment, duke qenë se faqja elektronike e kësaj komune azhurnohet në vazhdimësi”, thuhet tekstualisht në raportin e KDI-së për Zyrën për Informim Publik në Malishevë.

Fillimi i spërkatjes kundër rriqrave varet nga kushtet atmosferike

Malishevë, 26 prill

Kanë përfunduar të gjitha përgatitjet për fillimin e spërkatjes së zonave endemike, në kuadër të projektit për eliminimin e rriqrave si masë parandaluese kundër infektimit nga ethet hemorragjike, që bartet përmes rriqrës te njerëzit.

Në kuadër të këtij projekti, kanë përfunduar trajnimet dhe është kryer faza fillestare e projektit, ndërsa varësisht prej kushteve, fillon edhe spërkatja e zonave të parapara. Kështu është e ditur në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, të udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, ku drejtorët kanë raportuar për punën dhe aktivitetet e tyre, ndërsa vendin më të rëndësishëm e ka zënë, raportimi për ecurinë e projektit të lartëpërmendur, pasi për herë të parë, organizohet kjo formë e tillë e luftimit të rriqrave.

Drejtorët e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes, Skënder Hoti dhe Halit Zogaj, kanë raportuar se çdo gjë është gati, dhe se ka përfunduar edhe trajnimi i stafit, ndërsa pritët vetëm përmirësimi i kushteve atmosferike, kurse projekti mbikëqyret nga dy komisione profesionale dhe udhëhiqet nga Instituti Rajonal i Shëndetit Publik në Prizren.

Në mbledhjen sotme, para kryetarit, drejtorët kanë raportuar edhe çështje tjera, siç është inspektorati dhe aksionet e tyre në teren, të cilat janë konsideruar të suksesshme, pasi inspektorët komunal kanë arritur ta parandalojnë ekonominë informale dhe futjen e tyre në sistem.

Ndërsa sipas drejtorisë së Arsimit, në garat në nivel republike, nga lënda e kimisë, një nxënës nga komuna e Malishevës, e ka zënë vendin e dytë.

Shërbimet Publike, kanë konfirmuar se janë bërë ndërhyrje në ndërrimin e pompave në sistemin kryesor të ujësjellësit për qytetin dhe disa fshatra, ku është rritur kapaciteti i pompave dhe tani ka ujë 24 orë në ditë, pa ndërprerje.

Kryetari Kilaj: “Qendra e Kompetencës, rrugë drejt Evropës”

Malishevë, 29 prill

Sot është bërë prezantimi i projekt programit për Qendrën e Kompetencës në Malishevë, nga përfaqësuesit e Qeverisë Norvegjeze, IMG dhe MASHT-i, ndërsa nga kryetari i komunës, z. Isni Kilaj, kjo shkollë është cilësuar si një rrugë drejt Evropës.

“Kjo Qendër e Kompetencës është e para e këtij lloji në Republikën e Kosovës, nga e cila do të lëshohen certifikata me standarde evropiane dhe të njohura ndërkombëtarisht”, kështu është shprehur mes tjerash kryetari i komunës së Malishevës z. Isni Kilaj .

Të njëjtin vlerësim, e kanë bërë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, përderisa sipas tyre, arsimi profesional, asnjëherë nuk është trajtuar si duhet në Kosovë, ndërsa të rinjtë që do të dalin nga kjo shkollë, me këto certifikata, nuk kanë nevojë të sillen rrugëve të Evropës dhe të konsiderohen të pakualifikuar.



Më pas, përfaqësuesi i International Menagment Group (IMG), Argjend Karaj, ka bërë prezantimin e objektit, me



hapësirën e saj prej afro 10 mijë metra katrorë, hapësirë që nuk e ka asnjë shkollë profesionale në Ballkan, por të pakta janë edhe në vende tjera të Evropës. Karaj, ka prezantuar, klasat e mësimi teorik, punëtoritë, mënyrën e funksionimit të kësaj hapësire, shfrytëzimi i saj, gjenerimi i të hyrave përmes shfrytëzimit të hapësirës dhe të tjera, të cilat duhet ti bëj menaxhmenti i Qendrës së Kompetencës.

Ndërsa, përfaqësuesit e Agjencionit Norvegjez për Zhvillim (NORAD), kanë prezantuar projekt programin e mësimdhënies dhe trajnimet e nevojshme praktike që duhet të bëhen, në mënyrë që suksesti të mos mungoj, si dhe sfidat me të cilat mund të përballen menaxhmenti dhe mësimdhënësit.

Edhe përfaqësuesit e GTZ-së gjermane, kanë ofruar mbështetjen e tyre për zhvillimin e mësimi praktik, përmes asistencës së tyre, përderisa edhe komuniteti i biznesit të Malishevës, ka ofruar mbështetjen e tij për punën praktike, gjegjësisht ofrimin e praktikës në biznesin lokal.